

UDHËZIM
Nr.3, datë 11.1.2008

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003
“PËR AKCIZAT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Pika 2.4 e udhëzimit ndryshohet si vijon:
2.4 Autorizimi i akcizës i lëshohet personit që e kërkon atë njëherë me fillimin e veprimtarisë tregtare dhe është i vlefshëm deri në mbylljen e kësaj veprimtarie, me të paraqitur kërkesën për mbyllje.
2. Pika 2.5 e udhëzimit ndryshohet si vijon:
2.5 Në rastet kur aplikanti nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit dhe të këtij udhëzimi, organi tatimor mund t’i revokojë formularin e autorizimit të akcizës së lëshuar si “tatimpagues akcize i autorizuar”.
3. Pika 3.5 e udhëzimit ndryshohet si vijon:
3.5 Miratimi i magazinës tatimore i lëshohet personit që e kërkon atë, njëherë me fillimin e veprimtarisë tregtare dhe është i vlefshëm deri në mbylljen e kësaj veprimtarie, me të paraqitur kërkesën për mbyllje.
4. Pika 3.9 e udhëzimit ndryshohet si vijon:
3.9 Organi tatimor mund t’i revokojë formularin e miratimit të magazinës tatimore aplikantit, kur magazina tatimore nuk përmbush ndonjë nga kushtet e përcaktuara në paragrafin 3.8 me sipër ose kur aplikanti ka kërkuar miratimin për një operacion që nuk lejohet nga dispozitat e ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, apo të udhëzimit në zbatim të tij.
5. Pika 50.1 e udhëzimit ndryshohet si vijon:
50.1 Rimbursimi i akcizës mund të kërkohet në këto raste:
 - a) kur sasia e pullave të akcizës është prishur ose kjo sasi bëhet e papërdorshme, përpara se ato të ngjiten ose gjatë procesit të ngjitjes, kur ky veprim kryhet nga një makineri;
 - b) kur sasia e pullave të akcizës bëhet e pavlefshme për shkak të ndryshimeve në nivelin e akcizës;
 - c) kur sasia e paketave të cigareve me pulla akcize është e papërdorshme për treg;
 - d) kur sasia e pijeve alkoolike me pulla që mund të importohet, por nuk mund të shitet në treg dhe është e destinuar për të prodhuar pije të tjera alkoolike në Republikën e Shqipërisë.
6. Në pikën 50.2 të udhëzimit shtohet germa “d” me këtë përmbajtje:
d) Komisioni i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve vërteton nëpërmjet analizave të kryera se sasia e paketave të cigareve me pulla fiskale është e papërdorshme për tregun dhe duhet të asgjësohet, si dhe kërkon rimbursimin e akcizës në bazë të germës “c” të pikës 50.1 të këtij udhëzimi.
7. Në pikën 50.6 të udhëzimit shtohet pika “c” me këtë përmbajtje:
c) kthimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve i sasisë së paketave të cigareve me pulla fiskale, në vijim të miratimit nga Komisioni i ngritur sipas germës “d” të pikës 50.2 për asgjësimin e tyre, kur rimbursimi i akcizës kërkohet në bazë të germës “c” të pikës 50.1 të këtij udhëzimi.
8. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode